



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KRYETARI

Nr. 6084 Prot

Shijak, më 03.08.2020

VENDIM

Nr. 368, datë 03.08.2020

**“PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, ZONA 1 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHIJAK,
BASHKIA SHIJAK”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 13 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore, Vendimit Nr. 45, datë 22.01.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Shijak , Bashkia Shijak dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.70, datë 27.07.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në Nr. 15, datë 09.03.2020 “Për miratimin e planit të detyruar vendor për Zonën I, Njësia Administrative Shijak, Bashkia Shijak”, Konfirmimit të Prefektit të Qarkut Durrës, Nr.682/5, datë 30.07.2020, “Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona I Njësia Administrative Shijak, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, si më poshtë vijon:
 - a) Shtimin e kateve në objektet e reja shumëfamiljare, me njësi banimi (pallat), konkretisht 7 kate + 1 kat nëntokë (kati nëntokë të jetë për garazh , kati përdhes për njësi shërbimi dhe 6 katet e tjera për strehim të banorëve);


- b) Rindërtimin e objekteve të reja shumëfamiljare (pallateve) në truallin ekzistues;
 - c) Përfshirjen e shkollës “Petrë Llaftiu” tek Siti nr. 9, e cila nga aktkonstatimet përfundimtare është përcaktuar me dëmtime të nivelit DS4 dhe do t’i nënshtrohet procesit të rindërtimit.
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij, sipas ndryshimeve të miratuara.
 - 3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
 - 4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

Elton Arbana




RISHIKIM I PLANIT TE DETYRUAR VENDOR I ZONËS 1, ZONA E RE PËR ZHVILLIM , NJËSIA ADMINISTRATIVE SHIJAK,
BASHKIA SHIJAK
PARCELA PER RISTRUKTURIM DHE PARCELA PER RIZHVILLIM



Legjendë


	Konturi i Zonës së ndërtimit
	Pronësi shtet
	Zonë për Ristrukturim
	Zonë për Rihvillim
	Ndërtesa



BASHKIA SHIJAK
ZONA E RE PËR ZHVILLIM

Kryetar i Bashkisë
Z. Elton Arbana

Drejtori e Planifikimit dhe
e Zhvillimit të Territorit
Ing. Jonida Goga



PLANI I DETYRUAR VENDOR I ZONËS 1

EMERTIMI I FLETËS

PARCELA PER RISTRUKTURIM DHE PARCELA PER RIZHVILLIM

DATA 12.05.2020	SHKALLA 1:1000	ET. JUSË 02/06	NR. I GJEPËS 0015
--------------------	-------------------	-------------------	----------------------



Udhëheqja e Grupit (Planifikues Urban)	Ark. Francesco Spano	A. 1258
Koordinator Projekt	Urb. - Ark. Ervin Topi	A. 0210/5
Planifikues Territorial	Urb. Gjergji Torova	A. 0740/1
Arhitekt / Projektues Urban	Ark. Barbara Apollonio	A. 2018
Elaport GIS	Ingj. Genti Çajupi	T. 1284
Planifikues Transport	Ingj. Ivis Lika	K. 1380/1
Ekonomist Urban	Suzana Gjokaj	
Inshter / Elaport Medior	Albula Sim	M. 1343/1
Gjeolog dhe Hidrogeolog	Ingj. Florian Lili	Gj. 0535
Inshter Hidrologji dhe Injenerim, Injenerim dhe Injenerim	Ingj. Irfan Dugaj	H.T. 01529
Inshter Elektrik	Ingj. Agim Hoxha	E. 1284/1
Elaport Legjiv	Anda Dragaj	
Elaport i Traditueshme Kulture	Fida Pashko	R. P. 55